

VENDIM Nr. 17, datë 16.1.2019

PËR PËRCAKTIMIN E SHOQËRIVE TË TJERA SHTETËRORE OSE PRIVATE, TË RËNDËSISHME PËR INTERESIN E PUBLIKUT, PËR SHKAK TË NATYRËS SË BIZNESIT, MADHËSISË OSE NUMRIT TË PUNËMARRËSVE TË TYRE

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të nenit 2, të pikës 23, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Të përgjithshme

Shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës

së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, konsiderohen njësi me interes publik në rastet kur, njëkohësisht, plotësohen kriteret e njëres prej pikave të këtij vendimi, si dhe kushtet e detyrimit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar.

II. Klasifikimi për shkak të natyrës së biznesit

Shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës

së biznesit, klasifikohen, si më poshtë:

- a) Shoqëri ku shteti ka pjesëmarrje në kapital;
- b) Shoqëri që kanë më shumë se 50% të të ardhurave nga fondet publike;
- c) Shoqëri që operojnë si degë, shoqëria mëmë e të cilave është e listuar në bursë;
- ç) Shoqëri të cilat ofrojnë një të mirë publike në aktivitetin e tyre tregtar dhe janë subjekt i rregullatorëve të fushës përkatëse.

III. Klasifikimi për shkak të madhësisë së biznesit

Shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, të përcaktuara si

njësi ekonomike të mëdha, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, klasifikohen, si më poshtë vijon:

- a) Shoqëri që vlerën e totalit të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë;
- b) Shoqëri që vlerën e totalit të aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

c) Kur në datën e raportimit një shoqëri i tejkalon ose bie nën kufirin e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, cenohet klasifikimi, vetëm nëse kjo ndodh për dy periudha raportuese radhazi.

IV. Klasifikimi për shkak të numrit të punëmarrësve të tyre

Shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të numrit

të punëmarrësve të tyre, klasifikohen, si më poshtë vijon:

a) Shoqëri që, në fund të periudhës kontabël, kanë më shumë se 250 (dyqind e pesëdhjetë) punonjës;

b) Shoqëri që, për gjithë periudhën kontabël, kanë një numër mesatar punonjësish prej më shumë se 250 (dyqind e pesëdhjetë).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Botuar ne F.Zyrtare 4/2019

Dale nga shtypi me 18.01.2019